

## **Fjala e Rektorit të Universitetit Polis Prof.Dr. Besnik Aliaj në ceremoninë e diplomimit të vitit akademik 2016-2017.**

Të nderuar studentë diplomantë, pedagogë, prindër e të ftuar,  
Mirë se keni ardhur në Universitetin Polis!

Kjo është një ditë e shënuar për të gjithë pasi kurorëzohen më në fund përpjekjet e përbashkëta, dhe lançohet në jetë një gjeneratë e re profesionistësh dhe qytetarësh të denjë!

Personalisht i përkas gjeneratës që është diplomuar dhe ka filluar punë midis dy datave historike për vendin: 02 korrik dhe 08 dhjetor 1990. Sot, 27 vite më pas, shumë gjëra kanë ndryshuar për mirë, por shumë gjëra janë ende keq, dhe mjaft të tjera janë bërë më të vështira e më komplekse.

Nuk e di pse dhe për çfarë arsye, por situata sot më ngjan në shumë aspekte me dramën e fundit të viteve 80-të, dhe me kaosin dhe shpresat e fillimit të viteve 90-të! Çuditërisht sot duket se po i afrohem çdo ditë e më shumë ëndrrës Europiane, por ndërkohe çdo ditë po zbulojmë se vetë Europa nuk është perfekte, e madje ajo është vetë në ditë të vështira... Ndërkohë që gjithmonë e më shumë së bashku po vendosim norma dhe standarde, duket sikur hapësirat lirisë po i ngushtohen çdo ditë e më shumë. Jo rastësisht entuziazmi i shoqërisë dhe sidomos i rinisë ka rënë dukshëm! Njerëzit tashmë janë të lodhur nga politika dhe debatet shterpe! Shoqëria kërkon të lëvizë përpara, por është disi e pamundur! Kjo ndër të tjera sepse probleme të reja e të panjohura më parë për ne si shoqëri jo vetëm që kanë dalë në horizont, por tashmë janë një realitet i prekshëm për të gjithë!

Ju, ne dhe Polis tashmë jemi pjesë e këtij realiteti kompleks, që duhet ta themi troç shpesh herë na frustron! Për shembull, vetëm këtë vit rreth 10 mijë maturantë që mbaruan shkollat e mesme munguan në apel për t'u regjistruar në shkollat e larta të vendit, dhe nuk u regjistruan në universitetet shqiptare. Pse? Ndoshta sepse rreth 30% e kësaj braktisje vjen nga ulja demografike e popullsisë shqiptare në tërësi. Pra popullsia po zvogëlohet! Po edhe pse 70%-i tjetër duket se nuk ka më interes për shkollim, nuk ka më mundësi, ose ka zgjedhur që për një arsye ose tjetër të emigrojë. Pra më shumë qytetarë me nivel të ulët arsimor, ose më shumë të rinj cilësorë që largohen! Kaq mjafton të kuptosh se ne kemi aktualisht një problem serioz me sistemet e vlerave si shoqëri: kemi probleme me qeverisjen e mirë, kemi probleme me hapësirat e lirisë, kemi probleme me referencat morale dhe sociale, kemi probleme serioze me ekonominë, etj.

Në këto kushte, roli i profesionistëve, i njerëzve të mirë edukuar, i teknikientëve të zotë dhe intelektualëve të ardhshëm bëhet thelbësor! Duke kuptuar mirë rolin e edukimit për shoqërinë dhe atdheun, jo rastësisht në Universitetin Polis jemi përpjekur prej më shumë se një decade që të bëjmë jo thjesht ‘diplomim’ por edukim real të studentëve tanë. Sot uroj që t’ja kemi arritur kësaj sfide shumë të vështirë; ku jemi përballur së pari me vetveten dhe me studentët, por edhe me familjarët e tyre, edhe me miqtë tanë, shokët dhe të afërmit e përbashkët, sepse Shqipëria është një vend i bukur por i vogël, dhe shoqëria është si puna e atij ‘fshatit’ të vogël, ku të gjithë e njohin ose janë të ngatërruar me njëri tjetrin. Por ne kemi bërë të pamundurën që të dalim përtej këtij mentaliteti, shpesh edhe me kosto dhe keqkuptime. Jemi përpjekur të garantojmë cilësi për të themeluar një ‘ishull’ europian edukimi në vend, që rrit dhe edukon profesionistë dhe qytetarë të denjë! Një gjeneratë shprese dhe aktivizimi që ashtu si ne dikur në vitet ‘80-‘90të, do të gjenerojë sot përsëri një momentum lëvizjeje dhe shprese në vend! Ne të gjithë kemi nevojë për një energji pozitive, dhe une besoj fort se ju e zotëroni tashmë atë! Tani e tutje do të varet nga morali dhe ndërgjegjia juaj aftësia për t’i rezistuar të ‘keqes’ në këtë vend, dhe për të rrezatuar mirësinë, aftësinë dhe shpresën për të cilën kemi nevojë urgjente sot më shumë se kurrë!

Natyrisht sot ju urojmë më të mirën kudo që të shkoni si shqiptarë të mirë apo qytetarë të botës! Urojmë që studentët tanë të mos jenë të suksesshëm vetëm duke zënë një vend punë të mirë në Tiranë, Shkodër, Korçë apo në Vlorë, në New-York, Toronto, Romë apo Berlin. Unë kam një ëndërr, në kemi një ëndërr, që ish-studentët tanë të bëhen kampionë të ndryshimit kudo që shkojnë! Njerëz me kurajo dhe dinjitet që flasin hapur mendimin e tyre, që ngrenë zërin dhe protestojnë kur duhet, që dinë jo vetëm të kritikojnë po edhe të japin zgjidhje dhe shembullin personal! Nëse dikur ne thyem murin e frikës prej izolimit, kjo gjeneratë ka para sfidën e mposhtjes së ‘auto-censurës’, sfidën e ndërtimit të një shoqërie cilësore, të drejtë dhe sa më normale për të jetuar. Të një vendi ku jetohet mirë dhe me dinjitet. Të një vendi që nuk trashëgon ‘mallkimin’ e largimit të femijëve të vetë, por që si një “mëmë” zemërgjerë i mbledh të gjithë bijtë rrotull saj, që të ndihen mirë, të qetë e të sigurtë si në asnjë vend tjetër në botë!

Sidoqoftë, gjithmonë ka shumë arsye për të cilat së bashku duhet të jemi krenarë dhe të festojmë. Edhe pse vendi, demokracia dhe ekonomia mund të luhaten, Polis ka dëshmuar këto vite një stabilitet në rritje, jo vetëm në shifra prurjesh të reja, por sidomos në cilësinë e studentëve, gjë që dëshmon se njerëzit dhe shoqëria kanë besim tek ne! Tashmë ne jemi nga shkollat e pakta të fokusuara në vend që garantojmë programe në katër nivele edukimi. Këtë vit ne diplomuam edhe gjeneratën e parë të doktorantëve me studentë nga disa vende të Europës. Ne nuk jemi perfektë, dhe madje ka shumë për të bërë që të perfeksionohemi më tej. Po

ajo që spikat dhe që jep shpresë në këtë moment për të gjithë ne është vlerësimi maksimal që Universiteti Polis mori si institucioni më cilësor në vend ('best practice'). Pra sot të pakten le të mos jemi aq modestë dhe ta ndajmë me ju të vërtetën sepse ka momente që ajo duhet thënë me zë të lartë.

Për këtë me lejen tuaj unë do t'i referohem më poshtë Raportit përmbledhës të Agjencisë britanike të akreditimit QAA (Quality Assurance Agency) që monitoroi cilesinë e Universitetit Polis dhe të gjithë universitetetve publike dhe private në vend. Kjo agjenci i ka dërguar këtë konkluzion autoriteteve shqiptare për rastin tonë, dhe së shpejti për pak ditë Qeveria do të shpallë zyrtarisht rezultatet e këtij akreditimi-testim ndërkombëtar në kuder të refromës që po zbatohet, dukë bërë edhe klasifikimin e këtyre universiteteve.

---

### **Rreth Vlerësimit të QAA**

Qëllimi i përgjithshëm i këtij vlerësimi ndërkombëtar institucional është që të gjykojë në ç'masë secili IAL përputhet dhe respekton Standardet e Cilësisë së Shtetit Shqiptar dhe Kartës së Bolonjës, të cilat kanë hyrë në fuqi që në vitin 2011. Vlerësimi i akreditimit institucional ka qënë një proces ballafaqimi i drejtëpërdrejtë me stafin dhe studentët e çdo IAL-i dhe në bazë të dokumentacionit ligjor. Ekipi vlerësues ka qënë i përbërë nga ekspertë britanikë, të asistuar edhe nga ekspertë shtetërorë dhe të pavarur shqiptarë të përzgjedhur nga Agjencia britanike dhe nga Agjencia shqiptare e Akreditimit, së bashku. Ekipi gjithmonë ka qënë udhëhequr nga ekspertët britanikë të akreditimit.

Rezultatet e këtij vlerësimi nuk do të shërbejnë vetëm për qëllime akreditimi të institucionit përkatës, bazuar në shkallën që ata përmbushin standardet, por do të informojë për rezultatet të gjithë IAL-et, Qeverinë Shqiptare, opinionin publik, studentët, etj, për të kuptuar se ku qëndron çdo institucion i arsimit të lartë në përmbushjen e standardeve dhe kërkesave të arsimit cilësor. Ky raport do të ndihmojë gjithashtu çdo IAL që të përcaktojë prioritetet për përmirësime sistematike të mëtejshme për të mbështetur krijimin e një mjedisi sa më inkurajues të të nxëniet për studentët, etj.

Standardet e vlerësimit të cilësisë janë grupuar në 5 kapituj, që janë praktikisht edhe 5 kolonat kryesore të vlerësimit:

1. Organizimi dhe Menaxhimi
2. Burimet
3. Kurrikula
4. Mësimdhënia, të Nxëniet, Vlerësimi, Kërkimi
5. Studentët dhe mbështetja e tyre.

Raporti identifikon karakteristikat dhe praktikat më të mira, jep rekomandime, konfirmon veprime në një drejtim të caktuar në lidhje me pikat e dobëta, të forta dhe të suksesit, me një vlerësim final se sa mirë i ka plotësuar institucioni përkatës standardet ligjore. Vlerësuesit japin për çdo kolonë vlerësimi dhe për institucionin në tërësi një nga këto 4 vlerësime:

1. Standardet janë plotësuar tërësisht
2. Standardet janë plotësuar në pjesën më të madhe të tyre
3. Standardet janë plotësuar pjesërisht
4. Standardet nuk janë plotësuar

### **Konteksti i vleresimit**

Universiteti Polis është një institucion privat i vendosur në një nga korridoret kryesore të zhvillimit të vendit. Është themeluar nga një grup profesionistësh dhe akademikësh shqiptarë për të mbështetur integrimin e Shqipërisë me Europën dhe tendencat pozitive botërore. Misioni i tij është që të krijojë, transmetojë, zhvillojë dhe mbrojë dijen përmes mësimdhënies, inovacionit dhe kërkimit shkencor në fushat e dizjanit, arkitekturës, ndërtimit, shkencave të territorit e mjedisit, si dhe sipërmarrjes, menaxhimit e lidhshimit. Polis synon të promovojë zhvillimin e rajonit dhe vendit, duke kontribuar në rritjen e vlerave të demokracisë e qytetarisë, duke përgatitur gjeneratat që të përballen me dinamikën e shoqërisë. Universiteti Polis e ka marrë akreditimin e parë institucional që në vitin 2009, dhe atë programor në 2010. Në 2012 Ministria e Arsimit e akreditoi Polis me statusin Universitet, që do të thotë ndër të tjera që shkolla kishte aftësinë të ofrojë edhe programe doktorale. Polis ofron sot 4 nivele shkollimi: shkollë profesionale, tre programe bachelor, tetë programe master, dhe një Doktoraturë. Gjuha e ofruar në mësim është shqipja dhe anglishtja. Në vitin 2017, Polis kishte 318 studentë në programet bachelor, 503 në master, dhe 35 në doktoraturë. Shumica e studentëve vijnë nga Shqipëria, por Polis ka studente edhe nga Kosova 130, nga Italia 19, nga Maqedonia 10, nga Mali i Zi 7, nga Serbia 5, si dhe të tjerë nga 5 vende të tjera të Europës. Vitet e fundit Polis pranon në menyrë të stabilizuar më së paku 200 studentë të rinj në vit. Polis punëson rreth 100 pedagogë nga të cilët 70% janë full time, dhe të tjerët part time. 20% e stafit janë të huaj. Universiteti ka një prapavijë stafi mbështes prej 30 vetash. Polis ka qënë subjekt vlerësimi më parë edhe nga institucione të tjera akreditimi ndërkombëtare si psh: AESOP dhe ISO 9001, pa përmendur këtu që disa programe të tij plotësojnë standarde të vendeve partnere, falë universiteteve me të cilat bashkëpunohet në nivel master dhe PhD (Itali, Francë, Hollandë).

## **Përmbledhja e Gjetjeve të Raportit**

Polis ka traditën për të përgatitur sistematikisht raporte të vetë-vlerësimit të brendshëm, të cilat janë diskutuar me stafin, studentët dhe autoritetet. Universiteti ka një fryme maksimale bashkëpunimi, që u deshua edhe gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, ku u siguroa çdo informacion shtesë që iu kërkua dhe në kohë. Ekipi i vlerësimit fillimisht shqyrtoi gjithë dosjet ligjore dhe materialet përkatëse të lidhura me to. Pas kësaj u krye një mision në terren. Një database me rreth 140 aspekte dhe dokumentacione përkatëse shërbeu për të krijuar një panoramë paraprake për institucionin, strukturën, politikën, procedurat, menaxhimin, natyrën e mësimdhënies dhe kërkimit, etj. Provat e demonstruara përfshinë edhe statutin, rregulloren e brendshme, raportet vjetore, marrëveshjet e bashkëpunimit, minutat e takimeve, procedurat e pranimit, mënyrat e informimit, etj. Pas kësaj ekipi i vlerësimit u takua pothuajse me gjithë stafin përmes intervistave në formë grupi ose individuale. Takime u bënë edhe me drejtuesit, studentët, ish-studentët dhe me partnerët. Një vizite e plotë u bë për të parë infrastrukturen dhe kushtet fizike për mësim e kërkim. Shkolla ka laboratore kompjuterike si dhe për fusha të tjera specifike, një galeri për ekspozime, kantinë, hapësirë të përbashkët, studio punëtorie dhe klasa leksioni.

Konkluzioni i parë është se Universiteti i plotësonte tërësisht standardet sa i takon **organizimit dhe menaxhimit** të tij. Ai funksionon në bazë të statutit dhe rregullave të miratuara, dhe është i organizuar në atë mënyrë që garanton menaxhim eficient. Polis inkurajon debat konstruktiv dhe respekton kufijtë e autonomisë së tij. Ka një strategji zhvillimi që justifikon misionin dhe qëllimet e planeve të tij për të ardhmen. Ekipi vlerësues ka identifikuar një karakteristikë të “praktikave më të mira” që ka të bëjë me strategjinë efektive të zhvillimit të tij. Kjo ka mundësuar që universiteti të ketë një rol dhe impakt mjaft pozitiv për çështje të planifikimit dhe zhvillimit urban në Tiranë dhe në rajon. Ekipi nuk identifikoi pika të dobëta, dhe nuk ka rekomandime për përmirësim.

Universiteti përmbush tërësisht edhe standardet në lidhje me **burimet**: qofshin ato njerëzore, financiare, sistemet e informacionit, infrastrukturës, kushteve të punës e mësimi, ruajtjes së të dhënave dhe arkivës, etj. Ekipi identifikoi këtu dy praktika më të mira: *E para* - ka të bëjë me angazhimin e gjerë publik të stafit dhe studentëve në evenimente me impakt publik në fushat përkatëse të interesit, përfshirë: Javët e Arkitekturës dhe Dizjanit në Tiranë; *E dyta* - është mënyra se si universiteti promovon përmes dialogut social dhe konsulencës teknike kontributin e tij për reforma me rëndësi si ato në fushat e qeverisjes

vendore, të planifikimit dhe ndarjes territoriale, arsimit dhe shkencës, etj. Ekipi dhe këtu nuk identifikoi probleme, dobësi, dhe nuk sheh detyrime për përmirësim.

Universiteti ka përmbushur tërësisht edhe standardet në lidhje me **Kurrikulën**. Ai ka një variacion të pasur programesh studimi duke ruajtur fokusin e vetë sipas misionit dhe aftësive institucionale. Këtu ekipi vlerësues ka identifikuar tre praktika të mira: *Së pari* - rolin e programeve të përbashkëta me shkolla të huaja e cila inkurajon mobilitetin e studentëve. *Së dyti* - mësimdhënia në anglisht në disa programe master dhe në doktoraturë, inkurajon studentët të flasin dhe përdorin literaturë të huaj dhe të vijnë specializime më tej jashtë. *Së treti* - universiteti ka një strategji të qartë të ndërtojë partneritete dhe rrjete lokale me institucione publike, me kompani private dhe sipërmarrje ekonomike të cilat kanë impakt mjaft pozitiv si në përmirësimin e kurrikulës edhe në marketimin e studentëve për punësim. Edhe këtu ekipi vlerësues nuk gjeti ndonjë dobësi dhe nuk ka rekomandime për përmirësim.

Universiteti përmbush tërësisht standardet edhe për sa i takon **Mësimdhënies, të të Nxenurit, Vlerësimit dhe Kërkimit**. Ai përmbush gjithë standardet mbi mënyrën si ofron programet e studimit, metodave të përmirësimit të vazhdueshëm, organizimit dhe strukturimit të kërkimit. Ekipi vlerësues identifikoi tre praktika të mira: *Së pari* - kulturën gjithëpërfshirëse të punës për zhvillimin e strategjisë kërkimore, duke mundësuar përcaktimin e prioritetëve dhe ndër-disiplinaritetin në kërkim. *Së dyti* - aftësinë për të ndërtuar partneritet dhe për të organizuar një program ndërkombëtar doktorat të përbashkët me një universitet europian me reputacion në këtë fushë. *Së treti* - duke mundësuar angazhimin e stafit të ri në komunitetin kërkimor ndërkombëtar dhe në publikime serioze. Edhe këtu ekipi vlerësues nuk identifikoi pika të dobëta dhe nuk e pa të arsyeshme të japë rekomandime shtesë për përmirësim.

Universiteti përmbush tërësisht standardet edhe për **Studentët dhe Mbështjen e tyre**. Kjo si në lidhje me mënyrën e pranimit dhe orientimit, komunikimit, mbështetjes, literaturës, pjesëmarrjes në aktivitete me karakter kulturor e sportiv, si dhe ndjekjes e mentorimit edhe pas mbarimit të shkollës dhe sidomos gjatë karrierës së punësimit. Ekipi vlerësues identifikoi një praktikë të mirë e cila ka të bëjë me *Shoqatën Alumni* e cila grumbullon të dhëna statistikore periodike me vlerë rreth punësimit të studentëve dhe sidomos për të kuptuar nevojat e tyre për njohuri në praktikë. Kjo ndihmon më tej në përmirësimin e kurrikulave. Ekipi i vlerësimit edhe këtu nuk gjeti dobësi dhe nuk ka rekomandime të mëtejshme.

### **Përmbledhje e gjetjeve:**

Misioni i britanik i vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit identifikoi përmbushjen e plotë të të 5 kritereve të vlerësimit institucional të Universitetit Polis, dhe për më tepër evidentoi si rrallë më parë 10 praktika të mira.

Misioni nuk gjeti asnjë pikë të dobët esenciale, dhe nuk ka rekomandime për përmirësim.

Misioni nuk mendon se duhet të lërë detyra shtesë sepse institucioni ka provuar aftësinë që të vetë-organizohet dhe vetë-menaxhohet me sukses.

Në përfundim të vlerësimit mund të thuhet se:

1. Standardet e organizimit dhe menaxhimit plotësohen tërësisht
2. Standardet e burimeve mbështetëse plotësohen tërësisht
3. Standardet e kurrikulave plotësohen tërësisht
4. Standardet e mësimdhënies, të nxënit, vlerësimit dhe kërkimit plotësohen tërësisht
5. Standardet e studnetëve dhe asistencës ndaj tyre plotësohen tërësisht.

Në gjykimin përfundimtar Misioni i Vlerësimit i rekomandon Autoriteteve Shqiptare dhe Këshillit Kombëtar të Akreditimit se Universiteti Polis i plotëson të gjitha standardet ligjore të kërkuara për një akreditim ndërkombëtar dhe me afat maksimal e të plote 6 vjeçar dhe pa kushte.

---

Të nderuar pjesëmarrës në këtë ceremon

Duke ju kërkuar ndjesë për kohën, dua të nënvizoj se pas kësaj komentet janë të tepërta. I uroj studentët në emër të Bordit Thelemues, të Organeve Drejtuese dhe stafit akademik, kërkimor dhe administrativ! Urojmë të gjithë ata që diplomohen sot që të kenë një jetë sa më të mbarë dhe sukese në karrieren profesionale.

Urojmë sinqerisht që ju të jeni misionarë të ndryshimit dhe ri-sjellës të shpresës në këtë vend të bekuar që i ka të gjitha, por që kërkon dëshpërimisht qytetari, dashuri dhe lidhësi. Urojmë familjarët dhe miqtë e ftuar. Falenderojmë të gjithë ju për besimin e dëshmuar në punën tonë të vështirë, por mjaft fisnike dhe me shumë rëndësi për të ardhmen e vendit.

Rrugëtim të mbarë!

Polis mbetet ndërkohë gjithmonë shtëpia juaj dhe jona e përbashkët.